



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

“PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“QËNDËR MULTIFUNKSIONALE TEPELENË”, ME VENDNDODHJE  
NË TEPELENË, ME ZHVILLUES MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit Nr. 01, Datë 28.01.2025

PROJEKTUES:

“CEBRA”&“UNO ARCHITECTS” sh.p.k

ZHVILLUES:

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT



## TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

### 1. Dispozita të Përgjithshme

- 1.1 Baza Ligjore
- 1.2 Përshkrim i zonës së studuar

### 2. Analiza e Gjendjes Ekzistuese

### 3. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

- 3.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara
- 3.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave
- 3.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit
- 3.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërtë / vendparkimet

### 4. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

- 4.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

## **1. Dispozita të Përgjithshme**

### **1.1. Baza Ligjore**

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Zhvillimit për objektin: “**Qëndër Multifunksionale Tepelenë**”, me vendndodhje në Tepelenë, me zhvillues Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

bazuar në:

- Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
- Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregulloreve së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

### **1.2. Përshkrim i zonës së studiuar**

Qëndra Multifunksionale Tepelenë pozicionohet në një shesh ndërtimi me sipërfaqe prej 15.662 m<sup>2</sup>, e cila ndodhet në qytetin e Tepelenës.

#### ***Kushtet e Projektimit***

Projekti është zhvilluar duke ndjekur kushtet e mëposhtme:

- Qëndra Multifunksionale, dedikuar njohurive, kerkimit dhe komunikimit per lumin Vjosa.
- Përshtatja me natyrën duke respektuar parimet mjedisore të zones.




Fig. 1 Vendndodhja (pozicioni gjeografik)




Fig. 2 Pozicionimi në zonë

## 2. Analiza e Gjendjes Ekzistuese

Tepelenë, vendi i përgjedhur për Qendrën Multifunksionale Tepelenë karakterizohet nga afërsia e tij e menjëherëshme me lumin dhe mjediset e tij natyrore. I vendosur në aksin e shëtitores së re përgjatë lIMIT, ofron një integrim më të thellë me natyrën. Vendit aktualisht po përdoret si vendgrumbullim.. Ne shohim karakteristikat dhe potencialet kryesore për sitin si:

- Dukshmëri e lartë nga zonat përreth, edhe kur afroheni nëpërmjet rrugës nga Tirana dhe Vlora.
- Afërsi me lumin.
- Mjedis dhe eksperiencë natyrale multisensoriale.
- Pamje nga qyteti dhe gryka nga të dyja anët
- Qasja nga qyteti (për shembull me këmbë) mund të ofrojë një përvojë gjithëpërfshirëse natyrore përgjatë lIMIT.
- Zonë më e madhe për aktivitete në natyrë, parkim dhe zgjerime në të ardhmen.
- Oftron një mundësi për të transformuar një zonë ekzistuese të degraduar (landfill) në një destinacion kulturor. Vendit ofron një ndjenjë të të qenit në afërsi me lumin dhe si i tillë “në” Parkun Kombëtar të LUMIT Vjosë. Kjo do t’i mundësojë Qendrës të integrohet plotësisht me natyrën dhe të krijojë një vlerësim të parkut të mrekullueshëm natyror edhe sa po mbërrin.




Fig. 3 Pamje nga zona

### 3. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

#### 3.1. Funksionet dhe aktivitetet e propozuara





Fig. 4 Plani i vendosjes së Qendres Multifunksionale

Qendra multifunksionale do te shërbejë si zemra e projektit, duke ofruar komoditet për vizitorët, ekspozita educative dhe hapësira per përfshirjen e komunitetit. Dizajni i tij do kete prioritet aksesibilitetin dhe qendrueshmerine, duke transformuar një hapsirë të degraduar ne një komunitet kulturor që mer jete. Qendra do te perfshijë një një masterplan interpretues që tregon historinë e lumit Vjosa, domethënjen gjeologjike dhe ekologjike dhe trashëgiminë kulturore. Një ndërtësë e dedikuar njohurive dhe komunikimit për lumin Vjosa duhet të jetë më shumë sesa thjesht një strehë. Nëpërmjet arkitekturës dhe hapësirave, ai duhet të transmetojë disi thelbin e vetë lumbit. Ndërtesa duhet të bashkohet dhe të respektojë natyrën ose të bëhet pjesë e saj, ndërsa natyra mbetet përvuja kryesore.



*Fig. 5 Pamje 3D*

I gjithe objekti është I shtrirë në një kat ku ka ambiente teknike, një lobi, zona educative dhe ekspozite, kafe një qendër kërkimesh etj. Zonat teknike janë lënë në afërsi të objektit në një strukturë pak të veçuar që të mos kenë shqetësim për cfarë ndodh në qendër. Ambienti I brendshëm është konceptuar si një krijim I copëzave për të dhënë ndjesinë e lumit, zhurmën e lumit dhe bukurinë e rrallë që ai ka.



*Fig. 6 Pamje 3D*

## Qendra Multifunksionale Tepelenë 1547 m<sup>2</sup>

Qendra Multifunksionale e Tepelenës është projektuar në mënyrë strategjike për të ofruar një përzierje mjedisesh edukative dhe rekreative. Ajo përmban një holl të hapur i cili do të shërbej si elspozitë (239.8 m<sup>2</sup>), 3 salla multifunksionale (154 m<sup>2</sup>) ku secila nga ato ka depo (28.4 m<sup>2</sup>) dhe hapësirë teknike (19.3 m<sup>2</sup>). Kemi në afërsi të hyrjes zonën e recepcionit prej (46 m<sup>2</sup>) me garderobë (9.9 m<sup>2</sup>), pas kësaj është projektuar një hapësirë e hapur e cila është si dhomë pritje (27.3 m<sup>2</sup>), dyqan (51 m<sup>2</sup>) dhe hapësirë bari (85.5 m<sup>2</sup>). Gjithashtu objekti ka 2 tualete për njerëzi me aftësi të kufizuara (9.8 m<sup>2</sup>) dhe 6 tualete për femra dhe meshkuj (13.7 m<sup>2</sup>) dhe një dhomë pastrami (5.8 m<sup>2</sup>). Objekti disponon dhe kuzhinë (30.7 m<sup>2</sup>) me 2 depo magazinimi (9.4 m<sup>2</sup>), një garderomë (15.7 m<sup>2</sup>) dhe 2 hapësira teknike (13 m<sup>2</sup>).

Një tjetër hapësirë është dhe hapësira e zyrave apo sallave të mbledhjeve. Kjo hapësirë përmban 2 zyra (42.7 m<sup>2</sup>), 2 salla mbledhje të mëdha (19.2 m<sup>2</sup>) dhe 2 të vogla (6 m<sup>2</sup>), dhomë printimi (8.8 m<sup>2</sup>) dhe një hapësirë depo (19.2 m<sup>2</sup>) si dhe një holl të madh ku ka garderobë, hyrje punonjesish etj (76.9 m<sup>2</sup>). Objekti ka dhe 3 tualete (12.9 m<sup>2</sup>) shtesë në pjesën e jashtme të qendrës multifunksionale. Duke qenë se mbulimi është më i madh se sa gjurma e ndërtesës hapesira e jashtme që krijohet nga soleta shfrytëzohet për ekspozitë apo në raste të veçanta organizimi.





Fig. 15 Ndarja funksionale

### **3.2. Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave**


Dizajnimi i një ndërtese që duket dhe ndihet si një peizazh e ndërtuar vetëm nga dy pjesë: soleta betoni që ngjasojnë me pllaka tektonike dhe shkëmbinj natyrorë. Këta elementë përbëjnë komponentët kryesorë të arkitekturës: strehën aktuale dhe strukturën mbajtëse. Midis tyre, sipër dhe rreth tyre, ne do të vendosnim bimësi dhe pemë për të arritur një përvojë në zhvillim të arkitekturës që përzihet në natyrë.



*Fig. 7 Pamje e Qendres Multifunksionale*

Pamjet dhe këndvështrimet e shumta, përveç lidhjes me zonën përreth, maksimizojnë sasinë e dritës natyrore, energjine diellore, për të arritur komoditetin maksimal përsa i përket kushteve ambientale.

Përzgjedhja e materialeve për Qendrën Multifunksionale është fryshtuar nga materialet prekëse, të qëndrueshme dhe të gërryera të lumit Vjosa. Pllakat e çatisë prej betoni që i referohen thollësisë dhe gravitetit të dolmonit të Vranishtit. Dyshemeja prej druri dhe shkëmbinjtë natyrorë bëjnë kontrast me materialet e “kutive”. Këta do të janë pjesë e ekspozitës vetë, secili me trajtimin e tij individual dhe të gjithë të fryshtuar nga parku kombëtar. Njëra do të ishte efekt pasqyrë, duke imituar brigjet delikate të ujit. Një tjetër mund të jetë toka e shtypur, duke ofruar një përvojë prekëse ose xham bruz, duke i bërë jehonë vetë lumit Vjosa.



*Fig. 8 Materialet e përdorura*

### **3.3. Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit**

#### **TREGUESIT E ZHVILLIMIT TE PROJEKTIT**

Sipërfaqe e përgjithshme e prones:  $18\,628\text{ m}^2$

Sipërfaqe e truallit që përdoret për zhvillim:  $18\,628\text{ m}^2$

Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):  $1547\text{ m}^2$

Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi toke:  $1547\text{ m}^2$

Sipërfaqe e projekzionit:  $4081\text{ m}^2$

### **3.4. Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / *në situatën urbane***

Ndërhyrja e propozuar integron më së miri me skemën ekzistuese pa pasur nevojë për ndërhyrje masive në të. Studimi do të pajiset me elementë shtesë thelbësore urbane si:

- Sinjalistikë për orientimin e trafikut
  - Instalimi me material të përshtatshëm sipas kritereve teknike
  - Vendkalimet për këmbësorë dhe P.A.K.
  - Hapësira të gjelbërta
  - Mobilim urban

Panvarsisht se propozimi ndodhet në afërsi te lumit të Vjosë, ai nuk cënون hapësiren ujore dhe nuk ka rrezik për rrëshqitje të mundshme si rrjedhojë e kësaj afërsie.



*Fig. 9 Plani i përgjithshëm i vendosjes dhe sistemimeve*

## 4. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

### 4.1. Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

Infrastruktura dhe aksesi: Rrugë te rendësishme si SH4 lidhin rrethin e Lumin Vjosë me qytete te rëndësishme te vendit si Tirana dhe Saranda. Aeroporti më i afërt është ne Tiranë dhe krijon mundësira për vizitorë ndërkombëtarë. Me tej aksesibiliteti do zhvillohet nga hapja e një aeroporti të ri në Vlorë, i parashikuar ne 2024, duke përmirësuar lidhjen dhe turizmin si potencial.

Aksesi në pronë bëhet nga rruga ekzistuese. Nuk ndërhyet në rrjetin rrugor dhe respektohet ai ekzistues.




Fig. 10 Rrjedha dhe levizhmeria

"CEBRA" & "UNO ARCHITECTS" sh.p.k